



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 19 tetor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca dhe Aurora Bakalli.

Mungoi: Sasha Gjokiq

Të pranishëm: Nenad Rashiq, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Fadil Rracaj- MPMS, Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Ervin Ibrahim- UNDP, Ukë Gashi- Presidenca e Kosovës, Tarkan Kosova- OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.10. 2011;**
- 3. Takim me ministrin Nenad Rashiq;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 12.10. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 12 tetor 2011.

3. Takim me ministrin, Nenad Rashiq

Fikrim Damka- Duke e falënderuar ministrin për prezencën e tij në Komision, tha se në Komision, jemi të interesuar rreth ligjeve nga sfera e fushës së mirëqenies sociale. Për këtë kemi pasur takime me shoqatat e pensionistëve. Jemi në pritje të projektligjit për pensionet e financuara nga shteti, por edhe të projektligjeve të tjera.

Nenad Rashiq- I falënderoi anëtarët e Komisionit dhe tha se Projektligji për pensionet e financuara nga shteti, është shumë i rëndësishëm dhe jemi angazhuar shumë seriozisht për një kohë të gjatë në këtë drejtim. Ky projektligj përbën një ngarkesë të madhe për buxhetin e shtetit. Ne jemi duke kaluar nga një sistem i vjetër, i organizuar në bazë të solidaritetit të gjeneratës për gjeneratën tjetër, në një sistem të ri të pensioneve. Fondi i Kursimeve Pensionale i para vitit 1999, nuk ekziston. Ne duhet ta formojmë një sistem të ri pensional, të qëndrueshëm dhe afatgjatë, gjithmonë në koordinim me Bankën Botërore dhe FMN-në. Ky projektligj, është në përputhje të plotë me rekomandimet e këtyre dy institucioneve. Projektligji përmban shuma të mjetëve të cilat janë fikse, për shkak të përlllogaritjes së saktë të kostos së projektligjit. Ky projektligj do të na kushtojë 19 milionë euro shtesë për një vit. Në projektligj, janë të parapara dy kategori të reja: pensionet familjare dhe pensionet për invalidët e punës. Duhet të jeni të kujdesshmëm dhe të mos i ndryshoni projektligjet, sepse ka refleksione të mëdha zinxhirore, të cilat e pengojnë miratimin e projektligjit.

Të gjithë do t'i kenë pensionet lineare, ndërsa kategorizimin do të mund ta bëjmë pas dy vjetëve. Problemet duhet t'i zgjidhim në mënyrë graduale dhe ju lus ta mirëkuptoni pozicionin tonë.

Fadil Rracaj- I informoi anëtarët e Komisionit se drafti është hartuar në pajtim të plotë me rregullat dhe procedurat e Qeverisë. Kostoja e lartë financiare ndikon në mosprocedimin e tyre me kohë në Kuvendin e Kosovës. Ne, në muajin prill 2011, me kohë e kemi proceduar projektligjin në Qeveri.

Fikrim Damka- E pyeti ministrin: Kur do të vijë projektligji në Kuvend?

Nenad Rashiq- Tha se projektligji do të dalë në mbledhjen e radhës në Qeveri.

Time Kadriaj- A keni kontaktuar gjatë hartimit të projektligjit me pensionistët dhe a i keni marrë opinionet e tyre?

Flora Brovina- Deklaroi se politikat sociale janë shumë të rëndësishme për një shtet. Njerëzit janë në gjendje shumë të vështirë, ku nuk mund ta sigurojnë ekzistencën e vet. Ne dëshirojmë që së bashku me juve të kemi kontakte me FMN-në dhe BB, në mënyrë që të njoftohemi edhe ne me rekomandimet dhe qëndrimet e tyre. Gjatë viteve, ka mundur të gjendet mundësia që të formohet fondi për pensionistë.

Ne duhet të debatojmë për modelin të cilin e zgjedhim për pensionet. Kategoritë sociale meritojnë një trajtim më të mirë.

Salihe Mustafa- Tha se ne do të punojmë shumë që ligji të jetë sa më funksional. Ne duhet të gjejmë mirëkuptim me pensionistët, për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, sepse këtë e kemi obligim.

Gëzim Kelmendi- Duke konstatuar se Kosova e ka popullsinë e re, krahasuar me rajonin, e pyeti ministrin: A do të jetë rritja e pensionit që parashihet me projekligjin e ri?

Nazane Breca- Sa janë konsultuar ekspertët e kësaj lëmie gjatë hartimit të këtij projektligji?

Aurora Bakalli- Konstatoi se dinjiteti i pensionistëve është mjaft i nëpërkëmbur dhe i bëri pyetje ministrit: Cilat janë përparësitë e këtij projektligji për pensionistët?

Bahri Thaçi- U shpreh i interesuar për një angazhim më të madh për të zgjidhur sa më mirë çështjen e pensionistëve, por edhe për një racionalizim në shpenzimin e mjeteve buxhetore nëpër projekte të ndryshme, ndonjëherë edhe të panevojshme. Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i prishim raportet me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Nenad Rashedi- Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, tha se nuk guxojmë t'i prishim raportet me organizatat ndërkombëtare. Unë po përpiqem për të ndarë sa më shumë buxhet për projektligjet tona. Kemi pasur kontakte me pensionistët dhe vazhdimisht ata kanë refuzuar propozimet tona. Ata kërkojnë rritjen e pensioneve pa miratimin e ligjit. Ata kanë kërkuar edhe kategorizimin e tyre, që përfshin pensionin rreth 250 euro. Kjo për neve është e pamundur në rrethanat aktuale. Ju premtoj se në çdo takim të ardhshëm, me përfaqësues të BB dhe FMN-së, do t'u ftoj juve si deputetë të merrni pjesë. Ne, brenda ministrisë, kemi shumë ekspertë dhe kemi një nivel shumë të mirë në këtë dimension. Shtetet e rajonit dhe ato në UE, kanë për qëllim që t'i ndërrojnë sistemet e pensioneve të bazuara në solidaritet. Ne do ta kemi sistem të pensioneve të qëndrueshëm dhe afatgjatë, edhe pse tash për tash kemi probleme. E dimë se pensionet janë të vogla, por ne kemi një popullatë të re, kështu që duhet të balancojmë në mes të interesave të pensionistëve dhe rinisë, pra zhvillimit. Kjo kushtëzon që pensionet të mos jenë më të larta. Përparësitë e këtij projektligji janë se për herë të parë kemi një ligj, i cili e rregullon këtë fushë dhe është projektligj i hartuar mirë, që krijon një bazë të mirë për përmirësime në vitet që vijnë.

Pensionet kontributpaguese do të jenë në shumën prej 101 euro.

Fadil Rracaj- Hartimin e projektligjeve e bëjnë ekspertët e angazhuar për këtë qëllim. Përparësitë e këtij projektligji janë se bëhet një rritje, sado simbolike qoftë, skemat pensionale që janë rregulluar me akte nënligjore, tash rregullohen me ligj. Qeveria ka mundësi ligjore për ta rritur pensionin, krijohet një metodologji e re e rritjes së pensioneve në bazë të rritjes së kostos së jetesës. Në këtë projektligj kanë gjetur vend dy kategori: pensionet e invalidëve të punës dhe pensionet familjare.

Nenad Rashiq- Deklaroi se jemi në drejtim të përmbushjes së agjendës legislative që e kemi pasur për vitin 2011. Jemi të interesuar të dimë se deri ku ka arritur Projektligji për invalidët, dëshmorët veteranët e UÇK-së dhe familjet e tyre? Ne e kemi gati për miratim edhe Projektligjin për skemën sociale, me të cilin synojmë të bëjmë një ridestitim të mjeteve të kategoritë që janë në varfëri ekstreme dhe për të cilin presim mbështetjen tuaj.

Flora Brovina- Kërkoj të dijë - Pse insistohet të ndahen veteranët nga ky projektligj? Ne kemi diskutuar shumë rreth kësaj çështje dhe kemi kërkuar të përfshihet edhe kjo kategori në këtë projektligj, sepse këto janë edhe kërkesat e kësaj kategorie. Për këtë, ne kemi propozuar që zbatimi i tij për veteranët, të fillojë nga viti 2015. Edhe shtetet që nuk kanë pasur luftë, së pari i kanë nxjerrë këto ligje për këto kategori.

Nenad Rashiq- Duke u përgjigjur, tha se po të përfshihen veteranët në këtë projektligj, atëherë projektligji mund të shtyhet, gjë të cilën unë nuk e dëshiroj. Për ta sjellë këtë projektligj deri këtu, ne kemi kontaktuar shumë gjatë me FMN-në. Përfitimet me para, kanë qenë shumë të lehta për t'u llogaritur, por përfitimet e tjera kanë qenë vështirë të llogaritshme. Po ashtu, për veteranët, duhet të dijmë numrin e saktë të tyre dhe kjo ka qenë arsyeja që ata kanë refuzuar që kjo kategori të përfshihet në këtë projektligj. Nëse insistoni për përfshirjen e tyre në projektligj, do të rrezikojmë seriozisht për shtyrje të këtij projektligji. Për FMN-në, rëndësi ka se sa do të jenë implikimet financiare po të përfshihen veteranët, dhe ne nuk e dimë për shkak se nuk e dimë numrin e saktë të tyre.

Nazane Breca- Kur është ditur, që veteranët nuk do të përfshihen në këtë projektligj, pse atëherë në titull të tij përmenden ata? Sa i takon projektligjit për skemën sociale, kujdes duhet t'i kushtohet kriterëve të përfitimit të saj. A keni paraparë ndonjë mekanizëm monitorues që të mos bëhet ndonjë keqpërdorim.

Nenad Rashiq- Duke u përgjigjur, tha se shpërndarja e ndihmës sociale është e decentralizuar dhe kemi një gjendje shumë shqetësuese nëpër komuna sa u takon keqpërdorimeve në këtë aspekt. Kemi monitoruar për atë që kemi pasur mundësi, por gjendja është e keqe. Kam biseduar me disa kryetarë të komunave për këtë problem.

Aurora Bakalli- E pyeti ministrin: A po monitorohet Ligji për personat me aftësi të kufizuara dhe sa po zbatohet obligimi që ka punëdhënësi për t'i punësuar këta persona sipas Ligjit?

Nenad Rashiq- Po e përgatisim aktin nënligjor për këtë çështje dhe po përpiqemi të bëjmë zgjidhje sa më të mirë.

4. Të ndryshme

Flora Brovina- Informoi Komisionin se është takuar me ministrin dhe zv.ministrin e Ministrisë së Financave për Projektligjin për invalidët, dëshmorët dhe veteranët e UÇK-së, gjithashtu jam takuar edhe me një zyrtar të FMN-së. Do të takohemi prapë me zyrtarët

e FMN-së në Kosovë dhe do të kërkoj që të na japin qëndrimet e tyre me shkrim. Jam takuar edhe me shoqatat e dala nga lufta.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka